



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 2413 / Prot.
16

Koplik, më 12/12/2025

V E N D I M

Nr. 47, date 11.12.2025

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe, së bashku me dokumentacionin tekniko
ligjor për akordimin e ndihmës Financiare për familjen e
Zotit Pretash Dodë Nilaj banesa e te cilit është djegur nga zjarri

Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe ne mbledhje e datës 11.12.2025 me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur ne Ligjin 139/2015“Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54, shkronja“dh“,Ligjin 45 neni 30,41 pika 1,2,3, datë18.07.2019“Per Emërgjencat Civile“, VKM_së nr.329 date 16.05.2012 kreu III/I “Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“,Udhezimi i perbashkët i Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263,datë 224.05.2013 „Për kriteret dhe procedurat dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësi natyrore ose fatëkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, VKB Nr.81..date 31.12.2024 Per miratimin e buxhetit të Vitit 2025.

V E N D O S I:

- 1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për ndihmen e menjëherëshme financiare familjes së z. **Pretash Dodë Nilaj**_në vlerën **500.000**(peseqindëmijë) lekë, për djegjen e banesës së tijë nga zjarri.
- 2-Burimi i financimit të jetë fondi i Emergjencave Civile parashikuar në Programin“**Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**“, në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për **vitin 2025** të miratuar me VKB. .81..datë 31.12.2024 në programin_“Perballimi i ndihmave të menjëhershne për familjet në raste fatkeqesie“.
- 3-Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjorë të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për familjen e z. **Pretash Dodë Nilaj**_në vlerën e demit nga ana ndertimore në shumen **2.154.281**(dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e një.) lekë, 50% i saj është **1.077.140,5** (një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e dyzet, presje pesë.) lekë,si dhe vlera e demit në

paisje është **301.800** (treqind e një mijë e tetëqind.) lekë ku 50% i saj është **150.900** (njëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë. Sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Malësi e Madhe. Vlera totale e dëmeve është **2.456.081** (dy milionë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e një.) lekë ku 50% i saj është **1.228.040,5** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e dyzet, presje pesë.) lekë.

4- Ngarkohet administrata e bashkisë Malësi e Madhe për likuidimin e shumës prej **500.000** (peseqindë mijë) lekë.

5. Pjesa tjetër e vlers do të planifikohet për likuidim në buxhetin e vitit 2026 është 728.040,5 (shtëqind e njëzetë e tetë mijë e dyzet presie pesë lekë) si pasojë e fondeve të pa mjaftueshme për kompensim

6. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Finances dhe sektori i Emergjencave Civile.

7. Ky vendim hyne në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr.139/2015 „ Per veteqeverisjen vendore“

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 11.12.2025

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 12.12.2025

